



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL<sup>1</sup>

*(I përmbledhur)*

Tiranë, më 24.05.2019, ora 13.00

**Drejton mbledhjen -  
Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

- 1- Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimi, për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.*
- 2. Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.*

#### **Marrin pjesë<sup>2</sup> :**

- |                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| 1. Ardian Dvorani   | (kryetar)            |
| 2. Vitore Tusha     | (zëvendës kryetare)  |
| 3. Fatri Islamaj    | (anëtar)             |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare)            |
| 5. Eriol Roshi      | (anëtar)             |
| 6. Fatjona Memçaj   | (anëtar)             |
| 7. Medi Bici        | (anëtar zëvendësues) |

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

<sup>2</sup> Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019. Për rrjedhojë nuk merr pjesë në rastin e shqyrtimit të gjetjeve për kandidaturën e kësaj kandidateje.

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

### **HAPET MBLEDHJA**

***Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani***, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

***Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani***, informon se në mbledhje nuk merr pjesë anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku, e cila, sipas njoftimit, e ka të pamundur pjesëmarrjen për shkak të një angazhimi tjetër zyrtar shumë të rëndësishëm.

Po kështu, edhe anëtarja Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në mbledhjen e sotme vetëm në shqyrtimin e gjetjeve të rastit të parë sipas renditjes të kandidimit të znj. Ardita Alsula për shkak se sikurse është e njohur për të gjithë pjesëmarrësit kjo kandidatë është një njeriu i afërt i familjes së saj.

***Ardian Dvorani*** lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimi, për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.*

*Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

***Anëtarët e Këshillit*** miratojnë rendin e ditës së programuar.

***Këshilli vijon mbledhjen*** me shqyrtimin e rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimet dhe gjetjet për disa kandidatë të tjerë për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese, duke filluar me rastin e parë, kandidimi të kandidatës Ardita Alsula.

***Ardian Dvorani*** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Ardita Alsula.

***Vitore Tusha***, parashtrohet relatimin për kandidaten Ardita Alsula për vendin vakant plotësues për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur në datën 26.11.2018 nga Presidenti i Republikës

***Ardian Dvorani*** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Erinda Ballanca* sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se pavarësisht afatit relativisht të shkurtër që ligji ka parashikuar, brenda të cilit kandidatët do të duhet të plotësojnë dokumentet duket se ky është një afat i prerë i përcaktuar në ligj. Si ILDKP edhe KED e kanë të pamundur që të përcaktojnë një afat tjetër, për më tepër referenca në ligj bën fjalë për ditë brenda afatit 15 ditore nga momenti i paraqitjes së kandidatit pranë KED. Për sa kohë që dokumentet e paraqitura bashkëlidhur relacionit përcaktojnë se ky afat ka kaluar, qoftë edhe një ditë, duke e llogaritur afati nga e nesërmja, mendoj se KED është në pamundësi për të pranuar deklaratën e pasurisë si të paraqitur në afat. Për këtë arsye proceduralisht duket që nuk kemi mundësi për ti dhënë më tepër kohë.

*Paraqitet në mbledhje anëtarja e Këshillit, zonja Fatjona Memçaj.*

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Avni Shehu.

*Fatjona Memçaj*, parashtron relatimin për kandidatin Avni Shehu për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Erinda Ballanca* sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vëna në dispozicion në mbledhjen e Këshillit, nuk konstatoj ndonjë parregullsi në procedurat e ndjekura deri tani për verifikimin e kandidaturës. Lidhur me qëndrimin e kandidatit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, Avokati i Popullit konstaton se ndonëse afati është i shkurtër, ai është një afat i caktuar në nenin 235 pika 2 të ligjit nr.115/2016. Në lidhje me kërkesën e bërë për ta shtyrë me 30 ditë të paktën afatin e paraqitjes së deklaratës, Avokati i Popullit nuk gjen mundësinë për ta pranuar pasi një gjë e tillë nuk rezulton në kompetencën e Këshillit. Vullneti alternativ i kandidatit për tu tërhequr nga kandidimi nëse nuk miratohet kërkesa për shtyrje afati është e qartë dhe nuk besoj se nuk ka vend për dyshim.

*Ardian Dvorani* i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Denar Biba.

*Vitore Tusha*, parashtron relatimin për kandidatin Debar Biba për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

*Ardian Dvorani* pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

*Anëtarët e Këshillit* nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca** sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vëna në dispozicion në mbledhjen e Këshillit, nuk konstatoj ndonjë parregullsi në procedurat e ndjekura deri tani për verifikimin e kandidaturës. Lidhur me shpjegimet e kandidatit për shkaqet e dorëzimit të deklaratës së pasurisë tej afatit dhe pamundësisë së tij për ta paraqitur për shkaqe objektive brenda afatit, Avokati i Popullit konstaton se ndonëse afati është shumë i shkurtër, ai është një afat i caktuar në nenin 235 pika 2 të ligjit 115 /2016. Për me tepër, nuk rezulton që ky ligj të ketë parashikuar mundësinë e Këshillit të vlerësojë objektivitetin e shkaqeve të mosparaqitjes në kohë të deklaratës pranë ILDKPI. Në këto kushte, pa i hyrë vlefshmërisë së shkaqeve dhe kohës së shkurtër që kandidatët sipas ligjit kanë pasur për të plotësuar këtë detyrim ligjor, Avokati i Popullit nuk gjen mundësinë procedurale për te mbështetur qëndrimin e kandidatit.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Kristaq Traja.

**Vitore Tusha**, parashtron relatimin për kandidatin Kristaq Traja për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca**, pasi sqarohet nga relatorja se kandidati nuk e ka plotësuar Deklaratën nga pamundësia që djemtë e tij të plotësonin formularët, në vijim, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature shprehet se konstatoj në mënyrë të vazhdueshme afatin e shkurtër të përcaktuar nga ligji dhe se Këshilli në momentin e përgatitjes së rregulloreve nuk ka pasur mundësi për të vënë një afat tjetër. Mendoj se afati është i përcaktuar në ligj në nenin 235 pika 2 të ligjit nr.115 /2016 dhe nuk rezulton që në ligj të ketë parashikuar ndonjë mundësi që për shkaqe objektive, Këshilli të ketë kompetencë për të bërë shtyrjen e afateve. Gjithsesi mendoj se këto fakte do të duhet ti shërbejnë Këshillit që në kuadër të shpalljeve të ardhshme të mendojnë për ndonjë procedurë që të japë pak më shumë kohë për këtë çështje, ndoshta duke e theksuar këtë në njoftimin publik. E kuptoj që këtë herë kemi qenë në pamundësi pasi kemi shpallur datën sepse kemi qenë edhe në një afat shumë të ngushtë për shkak të interesit të rëndësishëm të publikut për të pasur Gjykatë Kushtetuese funksionale, por duhet që proceduralisht të gjejmë një mënyrë që të garantojmë efektivitet në kandidimet e personave.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Theodhori Sollaku.

**Vitore Tusha**, parashtron relatimin për kandidatin Theodhori Sollaku për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca** i drejton Kryetarit të Këshillit Ardian Dvorani pyetjen se pavarësisht faktit nëse kandidati ka dorëzuar me vonesë deklaratën, procedura e kthimit të deklaratës së pasurisë pa veprime të asnjë lloji a mund të jetë objekt i shqyrtimit të këtij Këshilli? Është si të thuash të na e kthejë gjykata ankimin jashtë afatit pa asnjë veprim. Kush do ta konstatojë paraqitjen e deklaratës jashtë afatit? Ai organ ka marrë një vendim pa ju vënë në dijeni me çfarë kuptoj juve kryetar. Lexova në relacion që ka një komunikim me Këshillin në të cilin thotë është kthyer mbrapsht, pra nuk është vetëm konstatuar fakti, por është kthyer tërësisht mbrapsht.

**Ardian Dvorani** përgjigjet se ILDKPKI komunikimin e ka me Këshillin jo me kryetarin, të cilin e ka sjellë me shkresë zyrtare. Deklarata e plotësuar i është kthyer kandidatit jo Këshillit. Këshilli do ta bisedojë ligjin e zbatueshëm dhe rrethanat në dhënien e vendimit për këtë rast kandidimi. Gjithsesi në vendimet e deritanishme kemi qasjen se për shkak të mënyrës se si është formuluar ligji, ne nuk kemi si të ndërhyjmë në këtë procedurë. Ata vendosin vetë sipas rregullave që i përcakton ligji i tyre. Nëse ky mund të jetë problemi, këtë duhet ta rregullojë ligji, përfshirë edhe marrëdhënies mes KED dhe institucioneve të tjera që kanë kompetenca në procedurën e verifikimit.

**Erinda Ballanca**, pas këtyre shpjegimeve shprehet se kjo ishte për të evidentuar pikërisht që ndoshta në kuadër të punës time dhe vlerësimit që mund të ketë Avokati i Popullit nga pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit, të bëjë eventualisht këto lloj komentesh apo të kërkojë të bëhen ndryshime ligjore në të ardhmen, për ta bërë më të thjeshtë punën qoftë për Këshillin dhe qoftë për kandidatët e të kemi sa më shumë kandidatëve të vlefshëm. Mund të delegohet që të dy organet të përcaktojnë memorandumun e bashkëpunimit ose me një urdher të përbashkët të trajtojnë çështjet, një nga të culat është edhe ky rasti për Z. Sollaku. Në lidhje me rastin konkret e mendoj se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vënë në dispozicion në mbledhjen e Këshillit nuk konstatoj ndonjë parregullsi në procedurat e ndjekurat deri tani për verifikimin e kandidaturës nga ana e Këshillit. Lidhur me shpjegimet e kandidatit për shkaqet e dorëzimit të deklaratës së pasurisë tej afatit dhe të justifikimit që ai ka paraqitur, mendoj se ndonëse afati është shumë i shkurtër, ai është një afat i caktuar në nenin 235 pika 2 të ligjit nr.115 /2016. Për më tepër, nuk rezulton që ky ligj të ketë parashikuar mundësinë e Këshillit të vlerësojë objektivitetin e shkaqeve të mosparaqitjes në kohë të deklaratës pranë ILDKPI. Në këto kushte pa i hyrë

vlefshmërisë së shkaqeve dhe kohës së shkurtër që kandidatët sipas ligjit kanë pasur për të plotësuar këtë detyrim ligjor, mendoj se nuk ka ndonjë mundësinë procedurale për të mbështetur qëndrimin e kandidatit.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Konstandin Kazanxhi.

**Vitore Tusha**, parashtrohet relatimin për kandidatin Konstandin Kazanxhi për vendin vakant për gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca** sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vëna në dispozicion në mbledhjen e Këshillit nuk konstatoj ndonjë parregullsi në procedurat e ndjekurat deri tani për verifikimin e kandidaturës. Lidhur me shpjegimet e kandidatit për shkaqet e mosdorëzimit në kohë të deklaratës, vlerësoj faktin që ai ka sqaruar Këshillin se nuk ka refuzuar paraqitjen e deklaratës por se mosparaqitja është për shkak një afati që në gjykimin e tij është i shkurtër dhe i krijon pamundësi për të mbledhur të gjithë dokumentet që duhen bashkëngjitur deklaratës. Në këto kushte ndonëse afati është shumë i shkurtër, siç dhe Avokati i Popullit e ka përsëritur, ai është një afat i caktuar në nenin 235 pika 2 të ligjit nr.115 /2016. Nuk rezulton që ky ligj të ketë parashikuar mundësinë e Këshillit të vlerësojë objektivitetin e shkaqeve të refuzimit apo të mosparaqitjes në kohë apo të mospasjes mundësi për të paraqitur deklaratën dhe për me tepër që KED nuk ka kompetencë mbi ILDKPI-në për të urdhëruar në një mënyrë apo tjetër vënien e afateve të tjera për kandidatët. Në këto kushte, pa i hyrë vlefshmërisë së shkaqeve, por duke e gjykuar gjithësesi që koha ka qenë kohë objektivist shkurtër, mendoj se nuk kemi asnjë mundësi për të pranuar proceduralisht kërkesën apo shpjegimin e bërë nga ana e Z. Kazanxhi dhe se ndaj të njëjtin qëndrim si gjykimi i paraqitur nga relatori.

**Ardian Dvorani** i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Konstandin Kazanxhi.

**Fatjona Memçaj**, parashtrohet po të njëjtat gjetje në relatimin për kandidatin Konstandin Kazanxhi për vendin vakant për gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese, të shpallur Kuvendi në datën 04.03.2019.

**Ardian Dvorani** pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Anëtarët e Këshillit** nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

**Erinda Ballanca** sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vëna në dispozicion në mbledhjen e Këshillit, nuk konstatoj ndonjë parregullsi në procedurat e ndjekurat deri më tani për verifikimin e kandidaturës nga ana e Këshillit. Lidhur me shpjegimet e kandidatit për shkaqet e mosdorëzimit të deklaratës, mendoj se ndonëse afati është shumë i shkurtër, ai është një afat i caktuar në nenin 235 pika 2 të ligjit nr.115 viti 2016. Gjithashtu nuk rezultoi që ky ligj të ketë parashikuar mundësinë e Këshillit për të vlerësuar apo për të dhënë një afat tjetër. Ai afat është i përcaktuar qartë në ligj. Në këto kushte, pa i hyrë vlefshmërisë së shkaqeve apo kohës së shkurtër, pasi ne mendojmë qartësisht se koha ka qenë kohë shkurtër, mendoj se nuk kemi asnjë mundësi procedurale për të mbështetur dhënien se një afat tjetër kandidatit.

**Ardian Dvorani** në përfundim të shqyrtimit të gjetjeve lidhur me kandidaturat sipas rendit të ditës i paraqet Këshillit disa informacione lidhur me ecurinë e veprimeve dhe procedurave të verifikimit të kandidaturave, zëvendësimit të njërit prej këshilltarëve me një tjetër dhe çështje të tjera të organizimit të burimeve njerëzore të Gjykatës së Lartë në dispozicion të KED ndërkohë që vetë Gjykata e Lartë është tejte e ngarkuar me problematikën e saj në shqyrtimin dhe administrimin e çështjeve gjyqësore, përgatitjeve të bëra për të standartizuar strukturën dhe elementët përbërës të vendimeve që jep Këshilli për tërheqjet, lejimin ose ndalimin e kandidimit, për bashkërendimin e punëve dhe komunikimin institucional me organe të tjera informacionet dhe vendimet e të cilave janë të lidhura me sjelljen e informacioneve dhe ecurinë sa më të shpejtë të procedurave të verifikimit të kandidatëve nga KED, si organet e rivlerësimit kalimtar, ILDKPKI, DSIK etj.. Krahas përpjekjeve për përshpejtimin e procedurave për pajisjen e anëtarëve të KED dhe një pjesë të personelit mbështetës me certifikata sigurie, nga ana e organeve të shërbimeve informative nëpërmjet të DSIK është përcjellë edhe problematika e mënyrës së përcjelljes së informacioneve të klasifikuara për kandidatët. Për këtë qëllim, si rrugë e vetme zgjedhje për përcjelljen e informacionit të klasifikuar të organeve të shërbimit informativ tek KED është gjetur ajo që zbatohet edhe në skemën e ngjashme të dërgimit të informacioneve ndërmjet tyre dhe KPK e KPA. Prandaj KED do ta kërkojë këtë informacion nëpërmjet kërkesës drejtuar DSIK për ndihmë administrative për përcjelljen e informacionit të dërguar prej shërbimeve të përpunuar sipas dispozitave ligjore dhe rregullave të lidhura me këto informacione të klasifikuara. Gjithashtu informohet Këshilli se janë paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Apelit disa ankime kundër vendimeve të KED për ndalime të kandidimit. Së fundi, informohet Këshilli për përgatitjen që po bëhet në bashkëpunim me Euralius për

përmirësimin e projektit të Metodologjive të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturave dhe për nevojën e përcjelljes dhe shkëmbimit të mendimeve për këtë qëllim.

**Ardian Dvorani**, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 31 Maj, në orën 10.00, me rend dite, në varësi të ecurisë së përgatitjeve, diskutimi dhe miratimi i Metodologjive dhe shqyrtime të gjetjeve për raste të tjera kandidimesh,

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** deklaron mbylljen e mbledhjes.

#### **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 14.17**

**Sekretare**

**Ermelinda Kadiu**

**Dorina Dulaj**

**Redjona Myrtja**

**Kryetari**

**Ardian Dvorani**